

# Buletin

JANAR 2023



 0 800 14 000 / 038 200 41 508



 [infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)

**Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti vizitoi Stacionin Policor, QKMF-në në Lipjan dhe shërbimin e zjarrfikësve në natën e vitit të ri.**





# Disa pamje të mrekullueshme nga fshati i bukur i Krojmiri.





# Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në sallën e Kuvendit Komunal, ka mbajtur diskutim publik ku është prezantuar Draft – Plani Zhvillimor Komunal – Profilin e Komunës

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi ka thënë se hartimi i Planit Zhvillimor Komunal ka një rëndësi të veçantë për faktin se është dokument afatgjatë, që ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore.

Drejtori i DPUMM-së, z. Imri Semetishti ka thënë se ky dokument që është në fazën e hartimit dhe diskutimit publik, do të ndikojë drejtëpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve të komunës sonë. Ai ka shtuar se në Profilin e komunës janë përmbledhur, identifikuar dhe strukturuar informatat bazë në fushat tematike, ku përfshihet shqyrtimi i të dhënave për:

- Historinë e zhvillimit të Komunës;
- Gjendjen ekzistuese të Komunës; dhe
- Kapacitetet njerëzore dhe financiare.



# Nënkryetari për komunitete z. Lulzim Qerimi ka pritur në takim përfaqësues nga organizata “Let’s do it – Ta pastrojmë Kosovën” dhe rrjeti i Ambientalistëve “We Are One”.

*Nënkryetari Qerimi ka theksuar se Komuna e Lipjanit është gjithmonë përkrahëse dhe ofron bashkëpunim të sinqertë në aktivitetet që ndikojnë pozitivisht për qytetarët e komunë sonë.*





# Nënkryetari Diamant Bytyqi, priti në takim zv, Komandantin e Kampit Bonsteel, Kolonel Ozgur Ozgenc

*Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka pritur në takim Kolonel Ozgur Ozgenc zv Komandant në kampin e Bondsteel në Kosovë të shoqëruar nga John Walton major në këtë kamp dhe pjesëtarë të tjerë të KFOR-it turk nga LTM të vendosur në Lipjan.*

*Gjatë këtij takimi, nënkryetari Bytyqi dhe zv Komandanti Ozgenc kanë bisedua rreth sigurisë në Komunën e Lipjanit por edhe punët të cilët janë zhvilluar dhe janë duke u zhvilluar në të gjithë territorin e komunës si dhe çështje të tjera më rëndësi.*

*Komandanti Ozgenc, ka përgëzuar udhëheqjen e komunës për punën dhe ka vlerësuar lartë kontributin e tyre në shërbim të qytetarëve.*



# U nënshkrua memorandum bashkëpunimi për zbatimin e projektit INTEGRA

*Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Valentin Hoxha, drejtor i Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus për implementimin e projektit “INTEGRA-Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave, të rinjve dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë”*

*Qëllimi i këtij Memorandum është që të sigurojë një kornizë bashkëpunimi ndërmjet palëve për zbatim sa më të suksesshëm të projektit, do të mbështeten të kthyerit dhe popullsia që konsiderohet e cënueshme, për një fillim të ri në vendin e tyre, duke ju mundësuar kështu, që përmes ngritjes së kapaciteteve punësimit dhe vetëpunësimit, do t'ju mundësoj atyre të gjenerojnë të ardhura për familjet e tyre dhe të ndërtojnë jetën e tyre në Kosovë.*

*Projekti realizohet nga Preda Plus -WEntrepreneur dhe Komuna e Lipjanit.*





**Grupi i Grave në Lipjan në muajin janar ka zhvilluar takim të parë për vitin 2023, ku gjatë këtij takimi kanë diskutuar për Planin e Punës për vitin 2023 dhe koordinimin e aktiviteteve që dalin nga ky plan.**





# Me rastin e 15 Janarit - Ditës së Përkujtimit të Gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë

*Nënkryetari z.Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët, kanë bërë homazhe tek busti i Heroit Ismail Luma në Lipjan dhe tek varri i tij në varrezat e dëshmorëve në Shtime, po ashtu ky delegacion ka vazhduar vizitën në Kompleksin memorial në Reçak për të bërë homazhe në 24 vjetorin Masakrës së Reçakut.*

*Lavdi!*





# Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit është mbajtur mbledhje përkujtimore me rastin e 15 Janarit – Ditës së Përkujtimit të Gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë.





**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtorë, kanë pritur përfaqësuesit e Agjencisë së Statistikave të Kosovës të udhëhequr nga Ylli Shala koordinator për regjistrimin e popullsisë.**

*Temë diskutimi në këtë takim ishte projekti i Regjistrimit të Popullsisë 2023 në Kosovë dhe përgatitjet për zhvillimet e reja që dalin nga ky projekt.*



# KDI në raportin e saj e rendit Lipjanin me transparencë të lartë

**Komuna e Lipjanit ka treguar transparencë të lartë në të gjithë indikatorët matës në Transparometrën Komunal të publikuar nga #KDI në partneritet me konsorciumin e organizatave jo qeveritare “Aleanca Qytetare për Transparencë”.**

*Në këtë publikim pasqyrohen të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për gjysmën e dytë të vitit 2022 (korrik – dhjetor).*

*Kryetari Imri Ahmeti, është shprehur i kënaqur që KDI konfirmon edhe një herë që Komuna e Lipjanit mbetet komuna me transparencë të lartë në nivel vendi.*

*“Falenderoj të gjithë shëbyesit civil, bashkëpunëtorët dhe qytetarët lipjanas, që zotimin tonë për transparencë e llogaridhënie, një parakusht i qeverisjes së mirë, po e realizojmë edhe në praktikë”, tha ndër të tjera kryetari Ahmeti.*

Komunave Korrik – Dhjetor 2022		
	Pikët	Përqindje
1 Rahovec	90	93.75
2 Lipjan	89	92.71
	88	91.67
3 Prizren	87	90.63
	87	90.63
4 Drenas	87	90.63
	87	90.63
5 Gjakovë	87	90.63
	86	87.5
6 Prishtinë e Jugut		
10 Podujevë	84	89.58
11 Hani i Elezit	80	83.33
12 Skenderaj	79	82.29
13 Malishevë	78	81.25
14 Suharekë	82	85.42
15 Ferizaj	82	85.42



**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi i shoqëruar nga Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Anila Reqica Llugiqi, kanë pritur në takim drejtoreshën e shpellës së Gadimes Adriana Pllana.**

*Gjatë këtij takimi palët kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit, ku u dakorduan që në të ardhmën ky bashkëpunim të thellohet në të mirë të rritjes së turizmit tek Shpella e Gadimes.*



**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi, ka pritur në takim drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) Sami Mazreku, ku kanë biseduar rreth mundësive për fillimin e procesit të sigurimit shëndetësor dhe atij jetësor por edhe për benifitet shumta që sjell polica e sigurimit për institucionet.**

*Gjatë këtij takimi palët kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit, me ç'rast u dakorduan në parim që të zhvillojmë aktivitete të përbashkëta në të ardhmen.*





**Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me përfaqësuesit e projektit “Integra”, në sallën e Kuvendit Komunal kanë mbajtur sesion informues për thirrjen e publikuar për grantet që do të ndahen në kuadër të këtij projekti, ku janë prezantuar në detaje të gjitha fazat e projektit dhe procesi i aplikimit.**

*Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi tha se është i nderuar që ky projekt po implementohet në komunën tonë, duke theksuar se ky projekt dhe projekte të tjera të kësaj natyre do të gjejnë gjithmonë mbështetjen e komunës.*



# **Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi, ka takuar përfaqësuesit e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ku kanë diskutuar për projektin dhe krijimin e Forumeve të Komunitetit për Interes Publik.**

*Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi ka shprehur gatishmërinë dhe përkrahjen për iniciativën e themelimit të këtyre forumeve dhe tregoi gatishmërinë e Komunës së Lipjanit për të punuar për të avancuar marrëdhëniet ndëretnike përmes integritit të mençur.*





**Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi, ka pritur në takim Drejtorin Ekzekutiv nga Forumi i Aftësisë së Kufizuar Bujar Kadriun, me të cilin kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për angazhimin e 3 asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta në Komunën e Lipjanit për periudhën 18 mujore.**



# Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e radhës të cilën e kryesoi Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan pikat të cilat ishin të propozuara për rend të ditës.

*Gjatë kësaj mbledhje janë diskutuar Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023 si dhe raporti i punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim.*





# Mbahet takimi i parë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2023

*Kryesuar nga nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur takimin e parë për vitin 2023.*



**Udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Daut Azemi është mbajtur mbledhja e 12-të me radhë e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ku janë diskutuar pikat e rendit të ditës që ishin të parapara për këtë mbledhje.**

*Ndërsa, anëtarët e KPF-së pas diskutimeve kanë rekomanduar të gjitha pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës.*






# Kuvendi i Komunës së Lipjanit zhvilloi punimet e mbledhjes së 15-të

*Kuvendi i Komunës së Lipjanit udhëhequr nga Kryesuesi, Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 15-të me radhë, në të cilën u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës me një pikë shtesë.*



# Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë